

VENDIM
Nr.81, datë 27.11.2006

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA “AMAL”
SHPK PËR PERIUDHËN 1 JANAR 2005 DERI NË 31 DHJETOR 2005**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa b, 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2004 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 27.11.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “Amal” sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2005 deri më 31 dhjetor 2005,

VENDOSI:

1.Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga “Amal” sh.p.k., për periudhën 1.1.2005-31.12.2005, të jetë 4.15 lekë/kwh.

2.Ngarkohet “Amal” sh.p.k. dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta